



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-2257/21
Kaçanik, 26.02.2021

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **II-të (Dytë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2021 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 26 Shkurt 2021. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve të KK, pjesëmarrës në mbledhje ishin 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj me arsye anëtari, Selim Reka.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale; Bahri Selimi, Ramadush Osmani, Ukshin Qallaku, Festim Neziraj, Fatmir Loku, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Bejtulla Dalloshi, Arbnora Kuka, Fatlume Guri-Selimi dhe Hidajete Guri.

Nga strukturat vendore, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit, Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari i përshëndeti të gjithëve iu dëshiroj mirëseardhje, fillimisht i përgëzoj të gjithë qytetarët e Komunës së Kaçanikut për organizimin e Zgjedhjeve të 14 shkurtit, zgjedhjet fer, të lira e demokratike. Në këtë rast i uroj fitoren e LVV në këto zgjedhje.

Para se me filluar me mbledhjen, iu bëjë një njoftim së anëtari i KK nga PDK, Besim Vishi na është drejtuar me një shkresë njoftuese, me të cilën na njofton se tani e tutje do të vazhdoj aktivitetin e tij në Kuvendin e Komunës si anëtar i LVV. Kjo është bërë me dëshirën e tij, kështu që ne e pranojmë si të tillë.

Konstatojmë tani pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër, kuorumi ekziston, prezent në mbledhje janë 26 anëtarë, mungon me arsye anëtari Selim Reka, i njëjti me ka njoftuar së nuk mund të merr pjesë në mbledhje për shkak të infektimit me Covid-19. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e II-të (Dytë) të Rregullt për vitin 2021, data 26 Shkurt, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2020;

3. Raporti Vjetor Financiar për periudhën: Janar-Dhjetor 2020;
4. Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2020;
5. Propozim Vendim për lirim nga qiraja komunale për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2021; dhe
6. Informatë e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën: Janar –Dhjetor 2020.

Ju njoftojmë se pikët 5 dhe 6 kanë ardhur me vonesë edhe tek ne, por me diskutimet të cilat i patëm në KPF u pajtuam t'i procedojmë në KK dhe kuvendi të vendosë se a do të debatoj këto dy pikë apo jo. Pika 5 është mjaft me rëndësi, edhe në vitin e kaluar i patëm liruar nga qiraja komunale bizneset etj. për shkak të Covid-19 dhe ishte vendim i mirë. Kërkoj të deklarohemi për këto dy pika të cilat na kanë ardhur me vonesë, a jemi të pajtimit që të hyjnë në rend pune ?

z. Ekrem Kyçyku, Faleminderit kryesues, Fillimisht i dëshiroj mirëseardhje në LVV z. Besim Vishi, i uroj suksese. Të çështja e dy pikave, shumë herë po ndodhë me na ardhur materiale me vonesë. Kërkoj që tani e tutja materiali i mbledhjes të na vjen 7 ditë punë para mbledhjes. Ne do të votojmë këtë rend pune, me këtë vërejtje që të njëjtat mos të përsëritet për mbledhjet tjera.

Kryesuesi i Kuvendit, Atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim, kush është Për ?

z. Ekrem Raka, Unë jam për, por si procedurë njëherë të votohet për futjen e dy pikëve në rend pune (pikave 5 dhe 6), pastaj të votohet rendi i punës si tërësi, sepse ashtu siç u procedua, paraqet shkelje procedurale.

Kryesuesi i Kuvendit, Atëherë a jeni të pajtimit që pikët 5 dhe 6 të futën në rend pune ? Rezultati i votimit ishte njëzëri për. Atëherë rendin e punës e shtroj në votim si tërësi dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 6 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së I (Parë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 29.01.2021/ Lënda: 01Nr. 060/01-2257/21.

Pyetje dhe Kërkesa

znj. Nazife Krasniqi, Unë kam një Kërkesë nga komuniteti i lagjes në rrugën "Agim Bajrami" për çështjen e mbeturinave. Atje nuk po iu merreshin mbeturinat, por të njëjtit ishin të obliguar t'i sjellin diku në vendin ku merren mbeturinat. Kam kërkesë të rregullohet kjo çështje, të iu bëhet transporti i mbeturinave kësaj lagjeje dhe të kyçen në pagesa për shërbimin e mbeturinave.

z. Adnan Reka, Kryetar! Edhe në seancën e kaluar të bëra një pyetje për të cilën nuk mora përgjigje, as me gojë, as me shkrim.

1. Unë përsëri po ju pyes, Si mund të arsyetoni ngushtimin e rrugës 'Avdurrâhim Shehu' përballë shtëpisë së Inspektorit të Urbanizmit, për 80 m2, e me pas të bëhet edhe legalizimin i shtëpisë së Inspektorit në këtë sipërfaqe të rrugës, pa përfillur asnjë procedurë ligjore.

Kryesuesi i Kuvendit, Përgjigjet jemi kuptuar që do t'i merrni me shkrim. E kuptoj që sot janë sjellë me vonesë përgjigjet, por ju mund të ngitni sot dhe me trajtuar të njëjtat në mbledhjen vijuese. Unë e kuptoj problemin, por ka pasur mundësi që prona mos me u bartë ende në hartën e gjeoportalit. Nëse ka vendim të KK ajo nuk ka munduar me u trajtuar ndryshe, logjika ime thotë se nuk e di qysh është çështja. Është mirë me shikuar në kadastër a është bërë bartja. Vendimi nëse është i kuvendit, është dashur me u zbatuar qoftë nga drejtoria apo ndonjë mekanizëm tjetër relevantë.

znj. Kaltrina Kodra (Tafili), Unë e kam një pyetje për drejtorinë e Infrastrukturës dhe kërkoj të më përgjigjet këtu, pasi që është shumë e rëndësishme. Kërkoj të di, kur do të përfundoj rruga "Skënderbeu" më konkretisht pjesa nga "Ura e Hazirit" deri të lidhja me Hekurudhën? Ka disa muaj që kjo rrugë është në gjendje jo të mirë, dhe nuk keni marrë masa. Kjo rrugë është shumë e frekuentuar nga qytetarët e sidomos nga nxënësit. Nëse ka mundësi me u përgjigjur tani, sepse po me duket shumë me prituri edhe një muaj deri në mbledhjen vijuese të Kuvendit të Komunës.

z. Ramadush Osmani- drejtor i DSHPE, Unë po të përgjigjem sot dhe atë shumë shkurt. Sa po të bien dielli me shtruar asfaltin, diku një muaj apo dy javë, është në kuadër të kontratës që nuk ka përfunduar dhe si të krijohen kushtet, asfalti do të shtrohet në atë rrugë.

znj. Kaltrina Kodra (Tafili), Kushtet janë edhe sot, dielli është duke rrezuar, nuk është duke qarkulluar treni që 3-4 muaj, se nuk e di sa aksidente do të i kishim pasur në atë pjesë.

z. Ramadush Osmani, Kushtet nuk janë plotësuar, janë zyrtarët që e vlerësojnë së kur krijohen kushtet për shtrim të asfaltit.

Kryesuesi i Kuvendit, Përgjigjen e more Kaltrina, kështu që në rregull është.

znj. Hafize Sallahi, Përhëndetje për të gjithë, Unë e kam një pyetje apo sqarim; Ne e dimë që qytetarët e komunës së Kaçanikut, i bëjnë projektet me vetiniciativë dhe dorëzojnë për me u realizuar projektet. Mirëpo, sipas disa qytetarëve dyshojmë së punimet nuk kryhen sipas projekteve të cilët ata i dorëzojnë. A është e vërtetë së ndryshohet projekti këtu, e bëhet tjetër projekt? Nëse po, atëherë përse po i detyrojmë qytetarët me mbledhur mjete me bërë projekte?

z. Bekim Koxha,

1. Unë e kam një shqetësim për rrugën e f. Koxhaj, lagjja "5 Martirët", e cila rrugë është filluar me u ndërtuar, ndërkaq ka ngelë në gjysmë. Ku janë arsyet që janë ndërprerë punimet? A është ndarë buxheti dhe pse ka ngelur projekti në gjysmë?

2. Kam një pyetje lidhur me kërkesat të cilat i kemi ngritur në mbledhjen e kaluar, pse nuk janë kthyer përgjigjet?

3. Unë edhe me herët, disa herë kam pasur ankesa rreth pyetjeve dhe kërkesave të cilat i ngriti në mbledhje të KK. Në mbledhjen e kaluar i kam bërë 3 pyetje, ndërkaq vetëm për një pyetje kam marrë përgjigje. Nuk është hera e parë. Tani e kam një pyetje, nëse ka mundësi në mbledhjen vijuese të KK një temë që është në interes të KK dhe të ekzekutivit të komunës dhe të gjithë qytetarëve të komunës; Çështja e dhënies në shfrytëzim të pronave, të shqyrtohet edhe një herë në Kuvendin e Komunës duke marrë vendim për ndërprerje të punimeve në ato prona, sepse mendoj së është bërë një shkelje e madhe për ato toka, kështu që të stopohen ato ndërtime.

znj. Albana Lika (Troni), Përshëndetje për të gjithë,

1. Unë kam një pyetje për Kryetarin e Komunës; Kërkoj një sqarim rreth pjesës së lokacionit të Çerdhja e fëmijëve. Shumë qytetarë ende e kanë të paqartë se çka është duke ndodhur aty. Ndoshta ishte kanë mirë tani me ma dhënë një përgjigje që edhe qytetarët me ditur së çka është duke ndodhur aty. Ne po e dimë së ende jemi në proces gjyqësor, ndërkaq shumë flitet së aty ka me u ndërtuar një ndërtesë, ndërkaq prej disave pritet që ajo pjesë ka me qenë park. Normal edhe ju keni deklaruar që ajo pjesë ka me qenë park.

2. Pyetje për drejtorinë e Urbanizmit; Çfarë plani keni ndërmarrë për këtë vit për menaxhimin e mbeturinave, me konkretisht për një pjesë të Çerdhja e fëmijëve që po shfrytëzohet për vetura. Është më të ardhur keq se qysh krijohet aty deponi e mbeturinave. Është e vërtetë së qytetarët aty i hedhin mbeturinat, janë kamerat dhe mundeni me i parë së kush hedhë mbeturina aty. Duhet me u marrë më hedhësit e tyre, nëse janë raste sociale, me i hequr nga pagesa, nëse jo, atëherë me marrë diçka ndaj këtyre personave, përndryshe ajo pjesë kur po frynë era, mbeturinat po shpërndahen nëpër park e kudo. Me të vërtetë më vjen keq me parë atë gjendje të krijuar.

3. Pyetje për drejtorinë e Bujqësisë; Për kanalin e ujitjes në f. Kovaçec, lagjja Troni dhe lagjja Thaqi, projekti është dashur të përfundoj deri të lagjja Troni, por nuk është përfunduar. Na keni pas premtuar me kryer edhe ajo pjesë që nuk është përfunduar. Me intereson të di, Çka ka ndodhur me atë pjesë që nuk është përfunduar, edhe pse si projekt është dashur të përfundoj deri në fund ? Përgjigjen është mirë me marrë tani.

Kryesuesi i Kuvendit, Përgjigjet i merrni me shkrim, ne e bëme një tolerim, por pastaj këto çështje po zhvillohen në formë debati. Se çka ka me u bërë me atë projekt, vendosë KK e jo Kryetari i Komunës.

z. Adnan Reka, Nëse përgjigjet nuk na jepen në pyetjet dhe kërkesa, atëherë cili është hapi i mëtejshëm të cilin duhet ndjekur.

Kryesuesi i Kuvendit, Problemi të pyetjet dhe kërkesat është formë kjo me i ngritur shqetësimet e qytetarëve. Shumica e përgjigjeve unë jam i vetëdijshëm së nuk iu pëlqejnë shumicës së anëtarëve të KK. Sipas LVL nuk shoh së kryetari ka ndonjë obligim ligjor tjetër, përpos raportimit që e ka në KK. Ju nëse gjeni, na tregoni. Raporti i përformancës dhe raporti i transparencës janë bazë që ne poentohemi si komunë, pastaj raportimi i Kryetarit të Komunës para KK, tjetër rrugë nuk di që duhet ndjekur.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, Kryesuesi të dha përgjigjen, ndërkaq ju z. Adnan merrni hapat e mëtejshëm që mendoni ju së keni të drejtë me i marrë.

z. Adnan Reka, Për atë jemi ranguar si komuna e 7 me performancë.

Kryesuesi i Kuvendit, Rangimi i 7-të është sukses për komunën tonë, ka rangim edhe nën 30, kështu që mos të rrokemi për këtë çështje. LVL i jep shumë kompetenca Kryetarit të Komunës, unë jam kundër asaj, por ligji është asisoj, kështu që duhet me u pajtuar.

znj. Arlinda Rakoci-Raka, Përshëndetje për të gjithë, E kam një pyetje për drejtorin e DSHPE; Ka kohë që uji rrjedh të kompleksi "Panorama", ndërkaq nuk keni marrë asgjë në këtë drejtim. Rruga është shumë e frekuentuar, tani kur ka pasur ngrica, në mëngjes mund të themi së aty është bërë si patinazh. Kur i kam pyetur punëtorët pse, arsyeja ka qenë vinçi që po punohet aty. Desha me pyetur, A keni marrë ju ndonjë veprim si komunë në këtë drejtim?

Kryesuesi i Kuvendit, Pyetje dhe kërkesa të tjera nuk ka, fillimisht kur të merrni fjalën, mundoheni të thoni krejt atë që keni për të thënë, e t'i përthahemi rregullores e mos të tejkalojmë rregulloren, përpos në rastet kur iu përmendet emri. Kalojmë në pikët tjera të radhës;

2. Raporti i Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, është një material bukur voluminoz, ky është një raport i ekzekutivit për vitin 2020, nëse ka kush diçka lë të urdhëroj.

z. Ekrem Kyçyku, Unë e kam lexuar me kujdesë këtë raport dhe njëkohësisht kam bërë krahasime me raportin e vitit 2019. Të DAP në vitin 2019 janë pranuar 41122 lëndë, ndërsa në vitin 2020 janë pranuar 32681 lëndë, e që i bien shumë lëndë më pak, që kjo të bënë me kuptuar së është zvogëluar shumë puna në administratë. Të DSHMS, mungojnë shumë raporte e informatë të cilat kanë qenë në vitin 2019. Me vjen mirë që raporti i vitit 2020 nuk është kopi paste. Të kjo drejtori nuk ka asnjë informatë së sa pëlqime tekniko sanitare janë lëshuar, sa gjoha mandatorë sanitare janë lëshuar, sa inspektime janë bërë. A është bërë dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi, sa mostra të ujit janë marrë dhe a janë bërë analiza në aspektin fizik e bakteriologjik, sa vizita sistematike mjekësore janë bërë në shkolla, krejt këto kanë qenë në raportin 2019, ndërkaq në këtë raport nuk janë. Të DAK kemi pasur rast me diskutuar në mbledhjen e kaluar kur, dihet fakti së drejtoria raporton në periudha të caktuara. Të DEF, e kemi raportin financiar. Të DUKMM, thuhet së në fund të vitit 2020 është pranuar edhe elaborati i autostradës: Prishtinë –Shkup, i cili do të procedohet dhe ekzekutohet gjatë vitit 2021, kisha dashur sqarime për këtë. Të DBPZHR mbrojtje pyjeve janë konfiskuar vetëm 128.09m3dru. E kem një pyetje për drejtorinë e bujqësisë; të çështja ku thuhet së kemi pyllëzuar 10 ha sipërfaqe me fidanë, pisha dhe bagrem pisha dhe bagremë, ku është bërë kjo.

Kryesuesi i Kuvendit, Për elaboratin të autostrada që u kërkua sqarim, urdhëro drejtor;

z. Ukshin Qallaku-Drejtor i DUKMM, Të elaborati të autostrada, matjet janë bërë, është punë shumë voluminoze, ne kemi filluar me punë, nevojiten konsultime me Agjencionin, sepse ka shumë telashe dhe punë të tjera në atë drejtim. Në elaborat është edhe Gjurgjedell. Ne nuk e dimë a është shpronësuar dhe a është paguar ajo pronë dhe a duhet ajo pronë me kaluar në emër të komunës, pastaj është edhe pjesa e Gajrës, kështu që shumë punë që me u futur të dhënat në sistem.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, kjo është informatë, kështu që konstatoj së Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Raportin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2020 / Lënda: 01Nr. 104/02-5465/21.

3. Raporti Vjetor Financiar për periudhën: Janar-Dhjetor 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, janë pasqyrat vjetore financiare për të cilat njoftohet KK. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin;

z. Ekrem Kyçyku, Nga Raporti shihet së buxheti final ka qenë 9,66284€, e që është realizuar 8,111.52€ apo 94.15%. në krahasim me raportin 9 mujor financiar, kur realizimi ka qenë 50%, tani me këtë raport realizimi është dyfishuar në tre muajt e fundit. Kërkoj sqarime të nevojshme nga drejtori, pse ka arritur ky realizim kaq i madh në tre muajt e fundit. Shpenzimet kapitale, buxheti final është 2,119.66€ ndërkaq janë realizuar 1.654.08€, 78.04%. kjo shihet së këto shpenzime kanë shënuar rënie. Edhe këtë herë, të shpalosja analitike e Subvencioneve dhe transfereve kërkoj që t'na ofrohet një listë me shkrim në mbledhjen vijuese të KK. Të HVK në vitin 2020 shihet së janë realizuar 572.00€ apo 79%, është përqindje e mirë duke marrë parasysh së jemi në një vit pandemie. Të HVK të pashpenzuara janë 375,840€. Unë mendoj që ka pasur hapësirë për shpenzime më të mëdha nga këto të hyra. Nuk e di përse në këtë raport është përfshirë edhe Raporti për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditorit për vitin 2020.

z. Adnan Reka, Në f. 9, shuma e mjeteve nga GQ të alokuara, por të pashpenzuara prej 564.42€ , të cilat mjete kthehen si suficit në buxhetin e Republikës së Kosovës, sa është kjo shumë, sepse nuk ka 0 në fund.

z. Ekrem Raka, Ajo të cilën dua të potencoj lidhet me pyetjen e Adnanit. Në bazë të shifrave të cilat i kam nxjerrë unë, del së 101.99 € janë mjete të cilat kthehen në suficit në buxhetin e Republikës së Kosovës. Kjo shumë e mjeteve me u kthyer në suficit, për mua është e dhimbshme.

z. Bahri Selimi-drejtor i DEFZH, Përhëndetje të gjithëve; Me qëllim nuk e mora fjalën për shpalosje të Raportit vjetor financiar, sepse raporti ka shumë faqe, sipas pyetje, unë do të jap përgjigje. Të shumica e pyetjeve, përgjigjet janë, si të realizimi aq sa është shënuar, është shënuar buxheti fillestar dhe buxheti final, është një shumë prej 640.000 € që është rritur gjatë vitit apo 7.2 %. Krahasimi me raportin 9 mujor dhe raportin janar – dhjetor, me shifra nuk e kam llogaritur sa është tre mujori i fundit, por është gati 50%. Gjithmonë jam munduar që realizimi të jetë me i madh në 9 muajt e parë, mirëpo në vitin 2020 ka diferenca për shkak të specifikave që ka pasur ky vit si rezultat i pandemisë, si në prokurim dhe në çdo lidhje të kontratës ka qenë vit i problemeve, me rastin e inicimit të projekteve kapitale jemi vonuar, sepse të gjitha projektet, kontratat janë lidhur me vonesë. Tani si specifikë e këtij viti ka qenë shumë interesant, sepse operatorët e pandërgjegjshëm të cilët kanë ofertuar për projekte të caktuara më të mëdha sesa buxheti të cilin e kemi paraparë ne, në momentin që Zyra e prokurimit i ka shpallë të pafavorshëm, ata kanë bërë ankesë përsëri. Janë edhe disa probleme tjera të cilat na kanë dërguar në shtyrjen e mundësisë për me lidhur kontrata të rregullta. Punimet janë nisur pakëz me vonesë, në stacionin e fundit, komuna nuk guxon me ia dhënë mjetet e fundit pa e pasur pranimin teknik të projektit, dhe kjo ka të bëjë edhe me këtë që po e quajmë stacioni i fundit. Ka pasur edhe disa pagesa të cilat janë bërë të pagat si të shëndetësia dhe të arsimit, të cilat pagesa janë bërë në muajin tetor. E mira është që çdo tre mujor i vitit të

shkon paralelisht, mirëpo tre mujori i parë janar-mars, në ata muaj kishim veç obligime. Periudha prill-shtator, duhet me qenë periudhë më e shëndoshë në realizimin e investimeve. Investimet kapitale, kjo lidhet shumë me pyetjet me suficitin. Investimet kapitale kanë qenë shumë me të larta, por kanë mbetur me 78 %, kur të lidhemi me suficitin e vëreni. subvencionet, analitikat gjithsesi do t'ua dërgoj. Të HVK janë 79 %. Faleminderit për korrektësi, ka qenë vit pandemie, sidomos të Tatimi në pronë, nuk kemi mundur me realizuar të hyra të mjaftueshme, mirëpo komuna ka marrë disa vendime përmes KK për lehtësim ndaj qytetarëve përkatësisht ndaj bizneseve. Raporti i zbatimit të rekomandimeve të zyrës së auditorit, është kërkesë e MEF për atë është futur në raport. Zbatimi i rekomandimeve është bukur e lartë, mbi 80%. Suficiti, ne si komunë duhet me shpjeguar me gjatë, gjithë çka po flasim po e lidhim me vit pandemie 11 marsi e tutje, nuk kemi pasur asnjëherë shkallë me të lartë të realizimit të buxhetit. Unë jam i detyruar me raportuar deri më 24 dhjetor për realizim të buxhetit, deri atëherë me lejon sistemi. Deri me 24 dhjetor suficiti ka qenë 5295 €. Nga këto mjete pagat dhe shtesat realizimi është 100%, për shkak së janë marrë disa vendime për kompensimin e orëve shtesë për mjekë etj. Nga mallrat dhe shërbime 876€ kanë ngelë, 562€ shpenzime komunale, investime kapitale, granti qeveritar është shpenzuar gati %, kanë mbetur 3856€. Pas kësaj komuna ka pasur buxhet, ka realizuar pagesat, zotimet shpenzimet të gjitha i ka aprovuar pagesat. Kur të aprovojmë pagesat kjo i bien se i kemi kryer obligimet. Tani ka ndodhë një anomali, të niveli qendror të MEF e cila ka dërguar pastaj një email e cila ka thënë që disa pagesa kthehen, nuk realizohen mbesin si pezullim për shkak të bilancit bankar të pamjaftueshëm. Këtu ende nuk jemi definuar, kemi bërë ankesa, dhe këtë problem e kanë edhe shumë komuna tjera, pavarësisht nga kush udhëhiqe komunat. Për me ditur së a jemi mirë, duhet me qenë analistë, ashtu që krahasimet me i bërë me komuna. Ende nuk dihet për këto pagesa, e kam raportin deri me 24 dhjetor dhe si është tani. Nëse i realizojmë këto pagesa të disa projekteve, si për bulevardin, “Avdurrahim Shehu”, operatori për, Ndryshim publik të cilët ende nuk i kanë marrë mjetet, d.m.th. kanë mbetur pagesat pezull, këtu ka pësuar deri tani, operatorët dhe punëtorët e tyre. Për ne është me raportuar se e kemi 5.000 € suficitin, ndërkaq ende nuk e dimë së qysh ka me shkuar pezullimi i pagesave. Kjo po i bien sipas neve, ndoshta nuk po dua me u lëshuar në atë nivel, por nuk kanë qenë të zotë më ruajtur as thesarin e shtetit dhe kanë frikë se nuk i kanë mjetet buxhetore. Komunat i kanë mjetet buxhetore në buxhet, ndërkaq bilanci bankar qendror është 0. Jemi duke pritur dhe kur të realizohen këto pagesa, unë përsëri mund të iu informoj dhe shikojmë sa mjete mbesin. Të HVK në f. 9 në seancën e ardhshme kemi me sjellë vendim për bartje të mjeteve së është një shumë bukur e madhe, ndërkaq GQ iu kemi ofruar me shpenzim. Raporti ka shumë shënime, unë isha i përgatitur për me shumë pyetje, sidoqoftë iu faleminderit.

z. Bekim Koxha, Faleminderit kryesues, Unë desha me u ndërlidhë në raportin e kaluar të realizimit të buxhetit, ashtu që buxheti ishte shpenzuar diku 53 % për IK, shihet që punët po shkojnë ngadalë dhe në fund po vijmë në përfundim që punët nuk po kryhen e buxheti po kthehet në suficit.

z. Ekrem Raka, Atë që e tha drejtori i financave lidhur me suficitin buxhetor, unë po e marrë të mirëqenë, ndërkaq është mirë që kur të realizohen pagesat, drejtori të na njoftoj me suficitin buxhetor.

Kryesuesi i Kuvendit, Raporti ishte sa për njoftim, kështu që nga kjo del konstatimi së Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Raporti Vjetor Financiar për periudhën: Janar-Dhjetor 2020 / Lënda: 01Nr. 05- 400/01-2905/21.

4. Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Materialin e keni marrë, në raport jemi munduar me i përshirë në pika të shkurtër aktivitetin e KPF për 1 vit. Raporti është hartuar në bashkëpunim me Zyrën e KK. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin; Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë Raportin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës vendosi të,

Aprovoj

Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2020 / Lënda: 01Nr.60/01-5260/2021.

5. Propozim Vendim për lirim nga qiraja komunale për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2021;

Kryesuesi i Kuvendit, Një vendim të kësaj natyre e kemi marrë edhe në vitin e kaluar, ky vendim ka të bëjë me nenin 16 të rregullores për taksat komunale, kryetari e ka pa të arsyeshme dhe është e arsyeshme që bizneset të lirohen nga qiraja komunale për shkak të pandemisë, nëse kryetari donë me marrë fjalë, urdhëro kryetar;

Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, Unë kur vitin e kaluar kam bërë propozim për lirim nga qiraja të bizneseve për shfrytëzimin e pronës komunale, kam menduar që është e përfshirë edhe neni 16 i rregullores së taksave komunale, mirëpo kjo me ka ikur, kështu që tani është propozuar lirimi nga shfrytëzimi i qirasë komunale të shfrytëzuesve si në neni 16 të rregullores. Kërkoj nga KK që ta miratoni këtë Propozim Vendim.

Kryesuesi i Kuvendit, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

znj. Lirije Luta, Faleminderit kryesues, besoj së ky Propozim Vendim është shumë i arsyeshëm, duke marrë parasysh gjendjen e pandemisë dhe nuk e dimë sa do të zgjatë kjo gjendje. Vendimin të cilin e kemi marr në vitin 2020 ishte shumë i mirë, edhe ky vendim për lirim nga qiraja të bizneseve është shumë i mirë, kështu që unë do të përkrahi.

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

Vendim

Për lirim nga qiraja komunale për shfrytëzuesit e pronës komunale për vitin 2021, të përcaktuar në nenin 16 të Rregullores për Taksat Komunale /Lënda: 01Nr.104/02-5531/21.

6. Informatë e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën: Janar –Dhjetor 2020;

Kryesuesi i Kuvendit, Kjo është një Informatë e cila bëhet nga Zyra e Personelit, është kërkuar shumë herë në KK që të kemi informata të tillë, nëse ka kush diçka le të urdhëroj;

z. Adnan Reka, Nëse raportet nuk përputhën, atëherë fjala vjen cilit raport duhet besuar. Dokumentet që i sillni në kuvend a kanë kredibilitet, apo janë dokumente sa për ta kaluar radhën? P.sh. Raporti Vjetor Financiar me Informatën Personelit (IP) kanë shpërputhje. Në Raportin financiar, faqe 31, numri i të punësuarve në Administratën Komunale me orar të plotë është **117**, ndërsa në Informatën e Zyrës së Personalit është **123**. Numri i përgjithshëm i punëtorëve në Raportin financiar është **769**, ndërsa në IP është **789**. Pra, kjo na tregon mjaftueshëm për çfarë raporte dhe informata bëhet fjalë.

Kryesuesi i Kuvendit, Të dytë janë këtu (drejtori i financave dhe udhëheqësi i personelit), të dy e kanë fjalën;

z. Bahri Selimi, Të neni 25 e keni vërejtur e kërkon numrin e punëtorëve për miratim që janë me buxhet. Që është, 801 punëtorë, administratë, arsim, shëndetësi. E marrim dhjetorin se sa kanë qenë në dhjetor të vitit 2020. Administrata 117, arsimit, 546 punëtorë, shëndetësia dhe mirëqenia sociale 106 punëtorë , krejt kjo 769, ndërkaq pa plotësuar janë 32 vende.

znj. Hidajete Guri- Udhëheqës i Personelit- Në raportin e Zyrës së Personalit, numri i përgjithshëm i të punësuarve është 123 të punësuar në administratë, duke mos llogaritur shërbimin e zjarrfikësve, të cilët janë të transferuar në nivelin qendror, por paguhen nga buxheti i komunës. Ndërsa, numri i të punësuarve në tërë organizatën buxhetore, duke përfshirë, administratën, shëndetësinë, Kuvendin e Komunës, arsimin edhe zjarrfikësit, është 789, ndërkaq drejtori ka pasur mundësi mos me i përfshirë anëtarët e KK.

z. Bahri Selimi, Të numri 801 të punësuar, këtu është edhe KK. Unë e llogariti KK si kosto, por jo edhe si numër, megjithatë ne do t'i shikojmë me znj. Hidajete dhe iu njoftojmë. Të administrata komunale unë e kam shifrën e të punësuarve 117, ndërkaq në raportin e personelit është 123.

Adnan Reka, Edhe diçka, të numri i punëtorëve me kontratë në vepër, shënohet se janë të punësuar profesionist të fushës së gjeodezisë, ndërkaq kur e shikojmë gjeodezia më së paku ka realizuar matje. Çka iu kanë nevojitur këta punëtorë me kontratë në vepër në gjeodezi, nëse nuk ka pasur punë hiq.

znj. Hidajete Guri, Unë e kam cekur të procedurat për marrëveshje me shërbime të veçanta, së janë udhëhequr 7 procedura. Numri i të punësuarve ka qenë 14 gjatë tërë vitit, kjo ka ndodhur në gjashtëmuorin e parë, për shkak së me hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrat e Publik, nuk na është lejuar që procedurat për shërbime të veçanta me i udhëhequr Zyra e Personelit, dhe ne kemi zbatuar këtë dispozitë ligjore, dhe këto procedura me ligj i janë lënë me i udhëhequr Prokurimi Publik.

z. Bekim Koxha, Në komunë ka të punësuar të cilët marrin paga, ndërkaq nuk shkojnë në punë fare. Ka punëtorë të punësuar me emër dhe mbiemër në Shtëpinë të Kulturës, të cilët nuk shkojnë asnjë ditë në punë. Nuk e di arsien ku qëndron problemi që nuk shkojnë në punë ata punëtorë, ndërkaq të njëjtit marrin paga

Kryetari i Komunës, Ata të punësuar janë nga ministria të cilën e udhëheqë partia jote-NISMA z. Bekim. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) i ka punësuar në punë ata punëtorë.

z. Bekim Koxha, Zotëri kryetar, Bleranda Bajra nuk e kam punësuar unë, e as Lul Rexha. Me intereson të di, Pse nuk shkojnë në punë këta punëtorë ?

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Jo ju, por i ka punësuar MPMS dhe ai i mbikëqyrë. Unë nuk e di pse nuk vjen në punë ata punëtorë, mundesh me iu drejtuar ministrisë tuaj për këtë punë.

z. Bekim Koxha, Unë kam informata që këta zyrtarë janë të punësuar, marrin paga e nuk shkojnë në punë. Kryetar ju jeni ekzekutiv, ata janë punëtorë të juaj. Ata që po thua së janë punëtorë të subjektit tim politik, ata vijnë me rregull në punë.

znj. Nazife Krasniqi, Desha me pyetur për 18 punëtorët e shërbimit të zjarrfikësve, që paguhen nga buxheti i komunës, deri kur do të zgjatë kjo ? A kanë me u paguar sa herë këta punëtorë nga buxheti i komunës ?

Kryesuesi i Kuvendit, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë konstatoj së Kuvendi i Komunës u,

Njoftua

Me Informatën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, për periudhën: Janar-Dhjetor 2020 / Lënda: 01Nr. 104/02-2142/21.

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 12'10. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KK.

Procesmbajtës:
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli

Kemal Mërseli

REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 2017);

nga Mbledhja e II-të (Dytë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2021, mbajtur me 26 Shkurt 2021

1. Kemal Mërseli..... _____,
2. Hamid Guri..... _____,
3. Ahmet Luma _____,
4. Kadri Krivenjeva,..... _____,
5. Besim Vishi,..... _____,
6. Sali Malsiu..... _____,
7. Lirije Dema..... _____,
8. Pranverë Loku- Zharku..... _____,
9. Lirije Luta..... _____,
10. Vlora Dalloshi..... _____,
11. Nexhat Loku _____,
12. Agim Mani..... _____,
13. Adnan Reka..... _____,
14. Ekrem Kyçyku..... _____,
15. Fatijona Kyçyku..... _____,
16. Kaltrina Kodra..... _____,
17. Selim Reka..... _____,
18. Besnik Salihu,..... _____,
19. Nazife Krasniqi..... _____,
20. Arlinda Rakoci-Raka..... _____,
21. Shemsedin Luzha..... _____,
22. Albana Lika..... _____,
23. Rabije Sallahi,..... _____,
24. Hajredin Luta..... _____,
25. Hafize Sallahi _____,
26. Bekim Koxha..... _____,
27. Ekrem Raka,..... _____.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Përgjigje në pyetjet e asambleistëve të seancës së Kuvendit të datës 2021/02/26

E nderuar znj. Hafize Sallahi

Sa i përket pyetjes tuaj lidhur me realizimin e projekteve ju informojë se për shkak se kërkesat e qytetarëve janë shumë më të mëdha se buxheti të cilin ne e kemi të paraparë për realizimin e punimeve shpesh ndodh që nuk mund të realizohen të gjitha kërkesat të cilat qytetarët i kanë paraparë në projektet me vetiniciativë dhe për këtë duhet të bëhen ndërhyrje në projekte.

E nderuar znj. Albana,

Sa i përket kërkesës tuaj për të dhënë një sqarim lidhur me çështjen e Qerdhës (Objektit të vjetër) më lejoni t'ju informoj se procesi gjyqësor akoma nuk ka përfunduar, gjë për të cilën edhe ne shpresojmë që të përfundoj sa më shpejtë për faktin se Komuna e Kaçanikut sipas Planit Zhvillimor Komunal ka paraparë që ai objekt të rënohet dhe të rregullohet një park për të gjithë qytetarët.

Kryetari i Komunës së Kaçanikut

z. Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 17.03.2021

Për: Anëtarët e Kuvendit/ znj. Nazife Krasniqi
z. Bekim Koxha
znj. Arlinda Rakoci-Raka

Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruar para Kuvendit të Komunës, më datë 26.02.2021, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike.

znj. Nazife Krasniqi, Unë kam një Kërkesë nga komuniteti i lagjes në rrugën "Agim Bajrami" për çështjen e mbeturinave. Atje nuk po iu merreshin mbeturinat, por të njëjtit ishin të obliguar t'i sjellin diku në vendin ku merren mbeturinat. Kam kërkesë të rregullohet kjo çështje, të iu bëhet transporti i mbeturinave kësaj lagjeje dhe të kyçen në pagesa për shërbimet e mbeturinave.

- *Kompania regjionale "Pastertia"-njësia operative ne Kaçanik bënë grumbullimin e mbeturinave të gjithë konsumatorëve të cilët janë në sistem të menaxhimit të mbeturinave. Aty ku mundësohet shërbimi derë më derë, kompania e zbaton këtë model ndërsa në vendet ku është i vështirë ky lloj operimi atëherë caktohet një lokacion i përshtatshëm dhe në ditën e përcaktuar konsumatorët i sjellin dhe kompania i zbrazë kontënjëret familjarë.*

z. Bekim Koxha, Unë e kam një shqetësim për rrugën e Koxhaj të "5 Martirët", e cila është filluar me u ndërtuar, ndërkaq ka ngelë në gjysmë. Ku janë arsyet që janë ndërprerë punimet? A është ndarë buxheti dhe pse ka ngelur projekti ?;

- *Rruga "5 Martirët e Lirisë" në fshatin Koxhaj është duke u punuar në kuadër të kontratës "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale". Vitin e kaluar është filluar më trasimin e saj dhe shtrimin me shtersë zhavori. Shkaku i përkeqësimit të kushteve atmosferike punimet janë ndërprerë. Këtë vit do të vazhdohet edhe me pjesën tjetër. Në këtë fazë do të kryhen punimet e rregullimit të trasesë më shtersë zhavori.*

znj. Arlinda Rakoci-Raka, Përshëndetje për të gjithë, E kam një pyetje për drejtorin e DSHPE; Ka kohë që uji rrjedh të kompleksi panorama, ndërkaq nuk keni marrë asgjë në këtë drejtim. Rruga është shumë e frekuentuar, tani kur ka pasur ngrica, në mëngjes mund të themi së aty është bërë si patinazh. Kur i kam pyetur punëtorët pse, arsyeja ka qenë vinqi që po punohet aty. Desha me pyetur a keni marrë ju ndonjë veprim si komunë ?.

- *Drejtoria e Shërbimeve Publike ka njoftuar KRU "Bifurkacioni"-njësia operative në Kaçanik, kompani përgjegjëse për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit në zonën urbane të komunës sonë, për defektin në fjalë. Është shumë e vërtetë se rrjedhja vie nga lokacioni ku është i vendosur vinçi që shërben për nevojat e ndërtimit të ndërtesës të kompleksi "Panorama". Pasiqë punimet e vrazhta në këtë kompleks janë në fazën finale, vinçi shumë shpejt do të demontohet dhe defekti sanohet menjëherë.*


Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality Kaçanik

DATË/A:	16.03.2021
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Delegatët e Kuvendit Komunal
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Fatmir Loku, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigjeje në pyetjen e deputetës znj. Albana Lika Troni, lidhur me pyetjen për vazhdimin e ndërtimit të kanalit ujitjes në fshatin Kovaçec

Përmes kësaj shkrese ju informojmë lidhur me pyetjen e deputetes znj, Albana Lika Troni, lidhur me kërkesën për vazhdimin e investimeve në projektin e ndërtimit të kanalit të ujitjes në fshatin Kovaçec. Drejtoria e BZHRP-së për ndërtimin e kanalit të ujitjes në fshatin Kovaçec, ka paraparë investime në dy faza dhe ka realizuar projektin ashtu siç e ka paraparë. Këtë vite me planin e punës për vitin 2021 nuk kemi paraparë investime për vazhdimin e këtij projekti, ngase e kemi paraparë investime për ndërtimin e kanaleve të ujitjes në fshatin Nikaj dhe Doganaj. Mjete për vazhdimin e punës për ndërtimin e kanalit të ujitjes në fshatin Kovaçec për këtë vit nuk kemi, mbetet të shohim varësisht nga vlera ofertuese nga kompanitë që ofertojnë, në tenderin për rregullimin e kanaleve të ujitjes në fshatin Dogana dhe Nikaj.

Me respekt !



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Përgjigje në pyetjen e anëtarit të Kuvendit të Komunës, a.Adnan Reka.

z.Adnan Reka, Unë prapë po ju pyes, si mund të arsyetoni ngushtimin e rrugës 'Avdurrhim Shehu' përballë shtëpisë së Inspektorit të Urbanizmit, për 80 m², e me pas te behet edhe legalizimin i shtëpisë së Inspektorit në këtë sipërfaqe të rrugës, pa përfillur asnjë procedure ligjore.

Përgjigje- Me kërkesën e dates 03.10.2019 e z.Milaim Fuga për gjeodetin privat Zekirja Elezi për pergatitjen e skices/manualit për propozimin e kembimit të pronave në mes pronës private të Milam Fugës me nr. 881-2 dhe pronës Komunale me nr. Te parcelës 1855-1 me sipërfaqe të këmbimit 79 m², pasi që kjo kërkesë ju adresua në Kuvendin Komunal dhe si propozim-vendim kaloi në mbledhjen e mbajtur më datë 29.11.2019, atëherë zyra kadastrale ka bërë ndryshimet në bazë të lëndës me manualin e cekur më lartë nga gjeodeti privat dhe në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal 01. Nr. 464/01-36830/19 Kaçanik, 29.11.2019.

Me pas parcelat e pronarit të njete iu nënshtruan procesit të bashkimit për tu plotësuar kriteret e legalizimit të shtëpisë.

Përgjigje ju bashkangjiten të skenuara, kërkesa, fleta poseduese, kopjet e planit, propozim-vendimi dhe vendimi i Kuvendit Komunal.

Drejtori i DUKMM
Ukshin Çallaku